



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 269, Datë 11.09.2023

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR
APLIKIMIN E SHOQËRISË “SELCA ENERGJI” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC SELCA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.09.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1974/6 prot., datë 08.09.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k., e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 05.05.2010, i ndryshuar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974 prot., datë 27.07.2023, paraqiti aplikimin për modifikimin e licencës, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “Selca” nga 1,6 MW në 1,98 MW.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 09.08.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. me vendimin nr. 39/2010 i ndryshuar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 10.08.2023 dhe 11.08.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.08.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1974/3 prot., datë 18.08.2023, ERE iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për dijëni shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., duke kërkuar qëndrimin e MIE-s mbi mënyrën e trajtimit të kërkesës për modifikim licence në ERE, në kuadër të shtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara. Nga MIE nuk ka ende një përgjigje lidhur me kërkesën e ERE.
- ERE me shkresën nr. 1974//4 prot., datë 22.08.2023, i njoftoi shoqërisë mbi marrjen e vendimit nr. 245/2023 dhe evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974/5 prot., datë 24.08.2023, shoqëria “Selca Energji” sh.p.k. ka ritheksuar se Hidrocentrai i Selcës është një Hec ekzistues (ndërtuar në vitin 1968) i privatizuar, në pronësi të shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. Shoqëria nuk ka një kontratë koncensionit me Ministrinë e Energjisë pasi Hidrocentrai është i privatizuar në pronësi të shoqërisë dhe në këto rrethana nuk ka detyrime ligjore raportuese apo varësie ndaj këtij institucioni. Po ashtu, shoqëria ka dokumentuar në format fotokopje miratimin për shtesën e kapacitetit për lidhjen me rrjetin e sistemit të shpërndarjes nga OSSH sh.a. në të cilën nuk paraqitet ndryshim në skemën e lidhjes.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 15 “Modifikimi i Licencës”,

Pika 4

- **gërma “d”**: Miratimin/qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me trajtimin e rasteve për ndryshimin e kapacitetit të centraleve të prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara.
- **gërma “e”**: Miratimin/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi rritjen e kapacitetit të instaluar.
- **gërma “f”**: Miratimin/qëndrimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në rast se leja për përdorimin e burimit ujor vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selca” me kapacitet të shtuar prej 380 kW.
- Në zbatim të nenit 43, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: “...ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij” si dhe nenit 53, pika 2 e “Kodit të Procedurave Administrative” i cili përcakton se: “2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një

afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

- Me qëllim marrjen e një miratimi/qëndrimi të mundshëm nga MIE për kërkesën e dërguar nga ERE dhe marrjen e një miratimi/qëndrimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Agjencia e Mbrojtjes së Burimeve Ujore (AMBU), në lidhje me rritjen e kapacitetit të HEC “Selca” me 380 kW, vlerësohet të zgjatet deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Selca”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Selca”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SELCA ENERGI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI